

KEP TRUST

Pasqyrat financiare

Të përgatitura në përputhje me

Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(me raportin e audituesve të pavarur bashkëngjitur)

Përmbajtja

Faqe

Raporti i Audituesve të Pavarur

Pasqyra e Pozicionit financiar	1
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Balancën e Fondit	3
Pasqyra e Flukseve të Parasë	4

Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare	5 - 24
--	---------------



KPMG Albania Shpk Kosovo Branch
6, Pashko Vasa Street
Pristina, Kosovo
Telephone +383(38)246771
Telefax +383(38)610772
Email al-office@kpmg.com
Internet kpmg.com/al

Raporti i Audituesve të Pavarur

Për Bordin e Drejtorëve dhe drejtimin e KEP Trust

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të KEP Trust ("Organizata"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në balancën e fondit dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Organizatës më 31 dhjetor 2017, si dhe të performancës së saj financiare dhe flukseve të saj të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit tonë ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesve për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK), si dhe me kërkesat etike të Ligjit Nr. 04/L-014, "Për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim" dhe Ligjit Nr. 04/L-093 "Për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare", që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa si dhe me Kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që jepen në Raportin Vjetor 2017, por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesve mbi këto pasqyra. Raporti vjetor parashikohet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesve.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Pasi të lexojmë raportin vjetor, nëse arrijmë në përfundimin se në këtë raport ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me personat e ngarkuar me qeverisjen.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Organizatës për të vazhduar në vijimësi, për të dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe për të përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Organizatën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Organizatës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Organizata të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

KPMG Albania Shpk Kosovo Branch

KPMG Albania Shpk Kosovo Branch
6, Pashko Vasa Street
Pristina, Kosovo


Prishtinë, 30 mars 2018


KEP TRUST
Pasqyra e pozicionit financiar

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Euro)

	Shënimi	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aktivët			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	7	2,162,302	1,779,900
Huatë dhe paradhëniet për klientët	8	36,055,365	25,639,675
Aktivët e tjera	9	210,677	42,686
Zyra dhe pajisje	10	546,740	245,993
Aktivët e paprekshme	11	35,326	13,570
Gjithsej aktivët		39,010,410	27,721,824
Detyrimët			
Huamarrjet	12	23,642,135	13,971,140
Provizionet	13	187,167	162,111
Detyrimët e tjera	14	212,754	160,170
Gjithsej detyrimët		24,042,056	14,293,421
Balanca e fondit			
Suficiti i akumuluar		14,968,354	13,428,403
Gjithsej fondi		14,968,354	13,428,403
Gjithsej detyrimët dhe balanca e fondit		39,010,410	27,721,824

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Bordit i Drejtorëve më 30 mars 2018 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:


Shpend Nura
Kryeshef Ekzekutiv


Adrian Alo
Kryeshef Financiar

Shënimet në faqet 5 deri në 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

KEP TRUST**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse***(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Euro)*

	Shënimi	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga interesi	15	7,017,292	4,938,298
Shpenzimet e interesit	12	(1,271,871)	(717,925)
Të ardhura neto nga interesi		5,745,421	4,220,373
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet		60,450	71,297
Shpenzimet për tarifat dhe komisionet		(25,191)	(16,293)
Të ardhura neto nga tarifat		35,259	55,004
Të ardhura të tjera	16	293,861	315,066
Humbja nga zhvlerësimi i huave	8	(292,234)	(124,003)
Shpenzimet e personelit	17	(2,658,606)	(2,458,516)
Shpenzimet administrative	18	(1,016,871)	(950,276)
Shpenzimet e qirasë		(423,613)	(437,126)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10,11	(110,040)	(82,977)
Humbjet nga heqja nga përdorimi i pajisjeve	10	(8,170)	(875)
Shpenzim provizioni për padi e kërkesa	13	(25,056)	(10,590)
Shpenzimet operative		(4,534,590)	(4,064,363)
Suficiti para tatimit		1,539,951	526,080
Tatim mbi fitimin	19	-	-
Suficiti neto për vitin		1,539,951	526,080
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej suficiti gjithëpërfshirës për vitin		1,539,951	526,080

Shënimet në faqet 5 deri në 24 formojnë një pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

KEP TRUST**Pasqyra e ndryshimeve në balancën e fondit***(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Euro)*

	Suficiti i akumuluar
Balanca më 1 janar 2016	12,902,323
Gjithsej suficiti gjithëpërfshirës për vitin	
Suficiti neto për vitin	526,080
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse	-
Gjithsej suficiti gjithëpërfshirës për vitin	526,080
	<hr/>
Balanca më 31 dhjetor 2016	13,428,403
Gjithsej suficiti gjithëpërfshirës për vitin	
Suficiti neto për vitin	1,539,951
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse	-
Gjithsej suficiti gjithëpërfshirës për vitin	1,539,951
	<hr/>
Balanca më 31 dhjetor 2017	14,968,354

Shënimet në faqet 5 deri në 24 formojnë një pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

KEP TRUST
Pasqyra e flukseve të parasë
(Të gjitha vlerat janë në Euro)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operative		
Suficiti para tatimit	1,539,951	526,080
Rregullimet për:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10,11	110,040
Humbje nga zhvlerësimet e huave	8	292,234
Ndryshim provizioni për padi dhe kërkesa	13	25,056
Humbje nga pajisje	8,170	875
Të ardhurat nga interesi	(7,017,292)	(4,938,298)
Shpenzimet e interesit	1,271,871	717,925
	(3,769,970)	(3,475,848)
Ndryshime në hua dhe paradhënie	(10,558,718)	(8,552,075)
Ndryshime në aktive të tjera	(167,991)	21,030
Ndryshime në detyrime të tjera	52,584	(66,033)
	(14,444,095)	(12,072,926)
Interes i arkëtuar	6,868,087	4,795,137
Tatimi i paguar	-	(12,884)
Paraja neto e përdorur në aktivitetet operative	(7,576,008)	(7,290,673)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerje pajisjesh dhe përmirësimet në ambiente me qira	10	(416,453)
Blerje aktive të paprekshme	11	(24,261)
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese	(440,714)	(201,409)
Rrjedhje e parasë nga aktivitetet financuese		
Disbursimet gjatë vitit	16,375,000	12,335,000
Pagesa gjatë vitit	(6,802,024)	(4,441,021)
Interesi i paguar	(1,173,852)	(671,182)
Paraja neto nga aktivitetet financuese	8,399,124	7,222,797
Rritja/(rënia) neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj		
	382,402	(269,285)
Paraja dhe ekuivalentet e saj më 1 janar	1,779,900	2,049,185
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor	7	2,162,302
	2,162,302	1,779,900

Shënimet nga faqet 5 deri në 24 formojnë një pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

KEP TRUST

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Euro, përveç nese shkruhet ndryshe)

1. Informata të përgjithshme

Veprimtaria

Institucioni Mikrofinanciar - KEP Trust ("Organizata"), e njohur më parë si Kosovo Enterprise Program ("KEP") u themelua nga Organizata Humanitare International Catholic Migration Commission – Switzerland ("ICMC") dhe Prizren Business Club në Gusht 1999, dhe ishte licensuar për të vepruar si një institucion jobankar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ("BQK").

KEP u regjistrua si një Organizate Jo-Qeveritare ('OJQ') lokale më 4 Mars 2002, dhe u regjistrua në BQK si një institucion mikrofinanciar, jo-bankar, siç është përcaktuar në seksionin 2 të Rregullores 1999/21. Aktiviteti primar i KEP është të ofrojë shërbime financiare për individët dhe familjet me të ardhura të ulëta në Kosovë. Me 3 prill 2002, Autoriteti i Bankave dhe Pagesave në Kosovë aprovoi regjistrimin e Organizatës si OJQ NGO.

Më 31 dhjetor 2017 KEP operoi përmes 31 degëve (2016: 31 degëve), të organizuara në 3 regjione të Kosovës.

Zyra Qendrore e Organizatës gjendet në Rr. Pashko Vasa, Nr. 6, Prishtinë, Kosovë.

Organizata udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti Ekzekutiv. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga 5 anëtarë dhe të gjithë janë të pavarur dhe nuk janë të lidhur me interesat dhe aktivitetet e Kompanisë.

Bordi i Drejtorëve

Më 31 dhjetor 2017, përbërja e tanishme e Bordit të Drejtorëve të KEP është si më poshtë:

Koen Wasmus – Kryetar i Bordit

Florence Joigneault – Anëtar i Bordit

Andreas Thiele – Anëtar i Bordit

Labinot Çoça – Anëtar i Bordit

Ardi Shita – Anëtar i Bordit

2. Baza e përgatitjes

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të), të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

2.2 Baza e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

2.3 Monedha funksional dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro, e cila është monedha funksionale e Organizatës.

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të bëjnë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumën e raportuara të asetëve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Efekti i rishikimit të vlerësimeve kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Në veçanti, informacioni mbi elemente të rëndësishme të pasigurive në vlerësim dhe gjykime kritike në zbatimin e politikave kontabël, të cilat kanë efektin më të rëndësishëm në pasqyrat financiare, është përshkruar në shënimin 4.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në këto pasqyra financiare.

3.1 Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në fitim ose humbje me anë të metodës së normës efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma e cila bën aktualizimin e flukseve të pagesave dhe arkëttimeve të pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së pritshme të aktivitetit ose detyrimit financiar (ose sipas rastit mund të jetë një periudhë më e shkurtër) deri në shumën e mbartur të aktivitetit ose detyrimit financiar.

KEP TRUST

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Euro, përveç nese shkruhet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.1 Interesi (vazhdim)

Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, Organizata vlerëson flukset monetare të ardhshme duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme të huasë. Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha kostot e transaksionit dhe komisionet e zbritjet e tjera të paguara ose pranuar, të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që janë direkt të lidhura me blerjen apo lëshimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

3.2 Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifën dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit të një aktivi ose detyrimi financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv. Kur një angazhim i huasë nuk pritet të rezultojë në tërheqjen e një kredie, tarifën e lidhura të angazhimit të kredisë njihen në një bazë lineare përgjatë periudhës së angazhimit.

Të ardhurat e tjera nga komisionet njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve.

3.3 Aktivet financiare dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Organizata fillimisht njeh huatë dhe paradhëniet për klientët dhe huamarrjet në datën kur ato janë krijuar. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare (duke përfshirë dhe blerjet e shitjet e rregullta) njihen fillimisht në datën e tregtimit, e cila është data kur Organizata bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Një aktiv ose detyrim financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë plus (për një zë që nuk matet më pas me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen apo lëshimin e tij.

(ii) Klasifikimi

Referohu politikave kontabël 3.4, 3.5 dhe 3.6.

(iii) Çregjistrimi

Organizata çregjistron një aktiv financiar kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të rrjedhës së parave nga aktivi financiar, ose kur ajo transferon të drejtat për të marrë rrjedhë parash kontraktuale në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar janë transferuar ose në të cilat Organizata as nuk transferon e as nuk ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e aktivit financiar.

Organizata çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo përfunduar.

Organizata merr pjesë në transaksione me anë të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por në të njëjtën kohë ruan substancialisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse ruhen substancialisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet, atëherë aktivet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Transferime të aktiveve me mbajtjen e të gjitha ose substancialisht të gjitha rreziqeve dhe përfitimeve, janë për shembull, huazimi i letrave me vlerë ose transaksionet e riblerjes.

Kur aktivet i shiten një pale të tretë duke shkëmbyer normat totale të kthimit mbi asetet njëkohësisht, ky trajtohet si transaksion financiar i siguruar i ngjashëm me një transaksion të riblerjes.

Në disa transaksione të caktuara ku Organizata as nuk ruan dhe as nuk transferon kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar, ajo nuk e njeh aktivin nëse nuk ruan kontrollin mbi aktivin. Të drejtat dhe detyrimet e ruajtura gjatë transferimit njihen me vete si aktive ose detyrime, sipas rastit.

Në transferime ku kontrolli mbi aktivin ruhet, Organizata vazhdon të njohë aktivin sipas shkallës së përfshirjes së vazhdueshme të saj në aktivin financiar, e përcaktuar kjo nga masa e ekspozimit ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar.

KEP TRUST

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Euro, përveç nëse shkruhet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.3 Aktivet financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iv) Kompensimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare janë kompensuar dhe shuma neto është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Organizata ka të drejtën ligjore për të shlyer shumat dhe ka për qëllim të shlyejë në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidh detyrimin në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm kur lejohen nga standardet e kontabilitetit, ose për fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga një grup i transaksioneve të ngjashme siç është aktiviteti i Organizatës.

(v) Matja me kosto të amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

(vi) Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose çmimi që do të paguhej për të transferuar një detyrim, në një transaksion të zakonshëm, ndërmjet pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes, në kushtet aktuale të tregut, ose në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm ku Organizata ka akses në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi reflekton rrezikun e mos-performancës së tij.

Kur është e mundur, Organizata e mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar për këtë instrument në tregje aktive ose duke përdorur çmimet e kuotura të ndërmjetësuesve për instrumentet financiare të kuotara në tregje aktive. Një treg konsiderohet aktiv nëse çmimet e kuotuar janë lehtësisht dhe rregullisht të disponueshme dhe paraqesin transaksionet aktuale dhe të rregullta të tregjeve në bazë të marrëdhënieve normale në treg.

Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, Organizata bën matjen me vlerën e drejtë duke përdorur metodën e vlerësimit. Metodën e vlerësimit përfshijnë metodën e vlerës aktuale neto, flukset monetare të skontuara, krahasime me instrumente financiare të ngjashëm për të cilët ekzistojnë çmime të vëzhgueshme në treg dhe metoda vlerësimi. Për këto instrumente financiare, të dhënat e përdorura në model nuk janë të vëzhgueshme.

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Organizata vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen nëse evidencë objektive tregon se një ngjarje zhvlerësimi ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe që ngjarja e zhvlerësimit ka një ndikim në flukset e ardhshme të mjeteve monetare të aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Evidenca objektive që një aktiv financiar është zhvlerësuar përfshin mospagesen ose falimentimin e huamarrësit, ristrukturimin e huasë ose paradhënies nga Organizata me kushte që, në rrethana të tjera, Organizata nuk do të kishte konsideruar, tregues se një huamarrës do të futet në probleme likuiditeti, vlera e kolateralit zvogëlohet ndjeshëm si pasojë e përkeqësimit të kushteve të tregut ose të dhëna të tjera të monitorueshme lidhur me një grup aktivesh sikurse lëvizjet e pafavorshme në statusin e pagesave të huamarrësit për Shoqërinë, ose kushte ekonomike që janë në korrelacion me mos-pagesen ndaj Organizatës. Për qëllime të vlerësimit kolektiv të zhvlerësimit, aktivet financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të rrezikut të kredisë.

Këto karakteristika janë të rëndësishme për vlerësimin e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare për grupet e aktiveve të tilla duke qenë tregues i aftësisë së debitorit për të paguar të gjitha shumat e duhura sipas kushteve kontraktuale të aktiveve që vlerësohen.

Humbjet prej aktiveve të matura me kosto të amortizuar llogariten si diferencë në mes të vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit. Humbjet njihen si fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari zhvlerësimi kundrejt huave dhe paradhënies. Interesi mbi aktivet e zhvlerësuar vazhdon të njihet përmes shtyrjes së normës së zbritjes. Kur një ngjarje pasuese bëhet shkak që shuma e humbjes nga zhvlerësimi të ulet, atëherë ulja e humbjes nga zhvlerësimi kthehet nëpërmjet fitimit ose humbjes.

KEP TRUST

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Euro, përveç nëse shkruhet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.3 Aktivet financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

Organizata fshin kreditë dhe paradhëniet për klientët kur ato janë përcaktuar të jenë të paarkëtueshme. Aktivet e paarkëtueshme janë fshire nga fondi për zhvlerësim pasi janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme për të rimarrë aktivin dhe shuma e humbjes është përcaktuar. Rimarrjet pasuese të shumave të fshira më parë janë njohur në fitimin ose humbjen së vitit.

3.4 Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë, gjendje të pakushtëzuara në Banka dhe të tjera aktive financiare afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë, dhe përdoren nga Organizata në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Paraja dhe ekuivalentët të saj mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me koston e amortizuar.

3.5 Huatë dhe paradhëniet për klientët

Kreditë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivative, me pagesa fikse ose të përcaktuara, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Organizata nuk ka për qëllim t'i shesë në periudhë afatshkurtër.

Kreditë dhe paradhëniet fillimisht matën me vlerën e drejtë plus kosto të tjera direkte të transaksionit, dhe në vijim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.6 Huamarrjet

Huamarrjet janë pjesë kryesore e burimeve të financimit të Organizatës.

Huamarrjet maten fillimisht me vlerën e drejtë plus koston që i atribuohen direkt transaksionit, dhe më pas maten me koston të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.7 Aktivet e riposeduara

Aktivitet e riposeduara përfaqësojnë aktivitet jofinanciare të fituara nga Organizata në ekzekutim të kredive të vonuara dhe Organizata synon shitjen e tyre brenda një kohe sa më të shkurtër. Aktivitet njihen fillimisht me vlerën me të cilën fitohen si inventarë brenda aktiveve të tjera dhe më pas maten me vlerën më të ulët mes koston dhe vlerës së realizueshme neto ndërsa çdo ulje e vlerës së tyre njihet si humbje.

3.8 Zyrat dhe pajisjet

Zyrat dhe pajisjet maten me koston minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë. Kostoja përfshin shpenzimet që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-krijuara përfshin koston e materialeve dhe të punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për përdorimin e saj të synuar, si dhe koston e çmontimit dhe heqjes së pjesëve dhe rivendosjen e lokacionit në gjendjen e mëparshme. Kur pjesë të ndryshme të një pajisje kanë jetë të ndryshme të dobishme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta (përbërësit kryesorë) të pajisjeve.

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një pajisjeje njihet në vlerën kontabël të pajisjes në qoftë se është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të përfshira brenda pjesës do të rrjedhin në Organizatë dhe kostoja e saj mund të matet në mënyrë të besueshme. Shpenzimet e shërbimit të përditshëm të pajisjeve njihen në fitim ose humbje kur ndodhin.

Në fund të çdo periudhe raportuese menaxhmenti vlerëson nëse ka evidenca për zhvlerësim të mjeteve dhe pajisjeve.

Nëse ka tregues të tillë, menaxhmentin e vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila është përcaktuar si më e larta e vlerës së drejtë të një aktivi minus koston e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Vlera kontabël reduktohet në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin.

Një humbje nga zhvlerësimi e njohur për një aktiv në vitet e mëparshme kthehet, nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e aktivitet në përdorim ose vlerën e drejtë minus koston për shitje.

Fitimet dhe humbjet nga heqja nga përdorim përcaktohen duke krahasuar vlerën e marrë për aktivin me atë bartëse dhe njihen në fitim ose humbje.

KEP TRUST

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Euro, përveç nese shkruhet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.8 Zyrat dhe pajisjet (vazhdim)

(i) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi (amortizimi) llogaritet duke përdorur metodën lineare për të alokuar kostot e tyre për vlerat e tyre të mbetura mbi jetën e përdorimit të parashikuar:

Vetura	5 vite
Pajisje dhe mobilje	5 vite
Kompjuterë dhe pajisje elektronike	5 vite
Përmirësimet në ambiente me qira	Më e shkurtra mes jetës së përdorimit dhe afatit të kontratës

Vlerat e mbetura të aktiveve dhe jeta e përdorimit rishikohen dhe rregullohen nëse është e nevojshme, në fund të çdo periudhe të raportimit.

3.9 Aktivët e paprekshme

Aktivët e paprekshme të blera nga Organizata mbahen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet e mëvonshme mbi aktivët e paprekshme kapitalizohen vetëm kur rriten përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivin specifik për të cilin lidhet. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen kur ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje në baza lineare përgjatë jetës së dobishme të asetit. Jeta e dobishme e aktiveve të paprekshme është 10 vite.

3.10 Qiraja operative

Kur Organizata është qiramarrëse në një qira e cila nuk transferon kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë nga qiradhënësi të Organizata, totali i pagesave të qirasë ngarkohet në fitim ose humbje për vitin në baza lineare gjatë periudhës së qirasë.

3.11 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet në fitim ose humbje, me përjashtim të masës që lidhet me zërat e njohur drejtpërdrejt në kapitalin neto ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat tatimore të miratuara ose të vendosura substancialisht në datën e raportimit dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen ndaj diferencave të përkohëshme kur ato ndryshojnë, bazuar në ligjet që janë miratuar ose në thelb të miratuara në datën e raportimit. Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Organizata merr parasysh ndikimin e pozitave tatimore të pasigurta dhe nëse tatimet dhe interesat shtesë mund të jene ne vonese. Organizata beson se detyrimet tatimore të vlerësuara janë adekuate për të gjitha vitet e hapura tatimore bazuar në vlerësimin e shumë faktorëve, duke përfshirë interpretimet e ligjit të taksave dhe përvojën e mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësimet dhe supozimet dhe mund të përfshijë një seri gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme.

Për shkak të informacioneve të reja që mund të vihen në dispozicion, Organizata mund të ndryshojë gjykimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimin tatimor në periudhën kur është bërë një përcaktim i tillë.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet vetëm në masën që është e mundshme që fitimet e ardhshme të tatueshme do të jenë në dispozicion, kundrejt të cilave aktiviteti mund të përdoret. Aktivitet tatimor të shtyra rishikohen në çdo datë të raportimit dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimi tatimor përkatës të realizohet.

Pas rinovimit të Statusit të Përfitimit Publik, Organizata nuk është subjekt i tatimit mbi fitimin për vitin 2017 (shih shënimin 19).

KEP TRUST

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Euro, përveç nëse shkruhet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.12 Provizionet për detyrime dhe ngarkesa

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të shkuara, Organizata ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyre të besueshme, dhe ka shumë të ngjarë që për të shlyer detyrimin, të kërkohej një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike. Provizionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parë dhe, sipas rastit, rreziqet specifike të detyrimit.

3.13 Përfitimet e punonjësve

Detyrimet për kontributet në planet e pensioneve me kontribut të përcaktuar njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Organizata paguan kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve pas daljes në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Kosovë sipas një plani kontributesh të përcaktuara.

3.14 Standardet dhe interpretimet e reja ende të pazbatuara

Një numër standardesh të reja, amendime apo interpretime të tyre janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë pas 1 janarit 2018, dhe zbatimi i mëhershëm i tyre është i lejuar; megjithatë Organizata nuk ka zbatuar më herët standardet e reja gjatë përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare.

Standardet e reja ose të amenduara në vijim pritet të kenë një ndikim në pasqyrat financiare të Organizatës në periudhën e aplikimit fillestar.

IFRS 9 Instrumentet financiare

Në korrik 2014, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit publikoi versionin përfundimtar të SNRF 9 Instrumentet Financiare. SNRF 9 është efektiv për periudhat raportuese të cilat fillojnë më ose pas 1 janar 2018, ku zbatimi i mëhershëm është i lejuar. Organizata aktualisht ka në plan të fillojë të zbatojë SNRF 9 më 1 janar 2018. Organizata do të vlerësojë aktivet e saj financiare në mënyrë që të përcaktojë nëse kriteri i VPPI-së (p.sh. flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit) është përbushur. Në përgjithësi, për huatë e standardizuara, vlerësimi bazohet në karakteristikat e produktit. Përveç kësaj, Organizata është në proces të përditësimit të politikave dhe dizajnit të proceseve të reja të klasifikimit të aplikueshme për klasifikimin e asetëve financiare nga 1 janari 2018.

Organizatës do t'i kërkohej të regjistrojë një fond për humbjet e pritshme për të gjitha aktivet financiare që nuk mbahen me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, së bashku me angazhimet e huasë dhe çdo kontratë garancie financiare. Organizata do të zhvillojë metodologjitë e saj për të vlerësuar nëse ka një rritje të riskut kreditor. Organizata ende nuk ka përfunduar metodologjitë e aplikueshme sipas SNRF 9. Megjithatë, Menaxhmenti beson se humbjet nga zhvlerësimi ka gjasa të rriten dhe të bëhen më të paqëndrueshme.

SNRF 16 Qiratë

IFRS 16 paraqet një model të vetëm kontabilizimi në bilanc për qiramarrësit. Një qiramarrës njihet një të drejtë për të përdorur aktivin që përfaqëson të drejtën e përdorimit të këtij aktivi dhe njëkohësisht përbën edhe një detyrim qiraje që lidhet me obligimin për të shlyer pagesat e qirasë financiare. Ka disa përjashtime opsionale për qiratë afatshkurtra dhe qiratë për mjete me vlerë të vogël. Kontabilizimi për qiradhënësin mbetet shumë i ngjashëm me standardin aktual-për shembull, qiradhënësi do të vazhdojë ta klasifikojë qiranë si financiare ose operative.

SNRF 16 zëvendëson udhëzuesit aktualë të qirasë duke përfshirë SKK 17 Qiratë, KIRFN 4 Përcaktimi në rast se një marrëveshje përmban një qira, KIC-15 Qiratë operative - Incentivat dhe KIC-27 Vlerësimi i substancës së transaksioneve që përfshijnë formën ligjore të qirasë. Standardi është efektiv për periudha vjetore që fillojnë më dhe pas 1 janar 2019. Zbatimi i mëparshëm është i lejueshëm për ato entitete të cilat aplikojnë SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët në datën ose përpara datës së zbatimit të SNRF 16. Pritet që standardi i ri, kur të aplikohet fillimisht, do të ketë një ndikim në pasqyrat financiare pasi që do të kërkojë që Organizata të njohë në pasqyrën e saj të pozicionit financiar aktivet dhe detyrimet që lidhen me qiratë operative për të cilat Organizata vepron si qiramarrës. Ndikimi aktual i zbatimit të SNRF 16 në pasqyrat financiare në periudhën e aplikimit fillestar do të varet nga përbërja e portofolit të qirasë të Organizatës në atë datë, vlerësimi më i fundit i Organizatës nëse ajo do të ushtrojë opsionet e rinovimit të qirasë dhe shkallën në të cilën Organizata zgjedh të përdorë mjetet praktike dhe përjashtimet e njohjes. Një vlerësim më i hollësishëm do të bëhet në periudhën e ardhshme.

KEP TRUST

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Euro, përveç nëse shkruhet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.14 Standardet dhe interpretimet e reja ende të pazbatuara (vazhdim)

Amendime të tjera

Standardet e reja apo të ndryshuara më poshtë nuk pritet të kenë efekt të rëndësishëm mbi pasqyrat financiare të Organizatës:

- SNRF 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët
- Përmirësimet Vjetore të SNRF: cikli 2014-2016 - Ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28.
- Klasifikimi dhe Matja e Transaksioneve të Pagesave Bazuar në Aksione (Ndryshim në SNRF 2)
- Transferimi i Aktiveve Afatgjatë Materiale të Investuar (Ndryshimet në SNK 40)
- Shitja ose Shtesa e Aktiveve ndërmjet një Investitori dhe Investimit të tij në një Pjesëmarrje ose në një Sipërmarrje të Përbashkët (Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28)
- KIRFN 22 Transaksionet në monedhë të huaj dhe paradhëniet
- KIRFN 23 Pasiguria mbi Trajtimin e Taksave mbi të Ardhurat
- Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNRF 9)
- Interesat Afatgjatë në Pjesëmarrje apo në Sipërmarrje të Përbashkëta.
- Përmirësimet vjetore të SNRF Cikli 2015-2017 - Ndryshimet në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12, SNK 23
- Ndryshimi i Planit, Kufizimi ose Shlyerja (Ndryshimet në SNK 19).

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Organizata bën vlerësime dhe gjykime të cilat ndikojnë vlerat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, përfshirë pritshmëritë mbi ngjarjet e ardhme të cilat mendohen të jenë të arsyeshme sipas rrethanave. Informacioni për provizionet dhe kushtëzimet është detajuar në shënimet 13 dhe 21.

(i) Fondet për zhvlerësim të huave dhe paradhënieve

Aktivitet e matura me kosto të amortizuara rishikohen për të përcaktuar humbjet nga zhvlerësimi sipas mënyrës së përshkruar në politikën kontabël 3.3 (vii).

Provizionet e vlerësuara në mënyrë kolektive për humbje mbulojnë humbjet në portofoliot e huave dhe paradhënieve për klientët me karakteristika të ngjashme ekonomike kur ka prova objektive që sugjerojnë se ato përmbajnë indikacione për humbje, mirëpo ende nuk mund të identifikohen zhvlerësimet individuale të tyre. Për të përcaktuar nëse një humbje nga kreditë duhet të regjistrohet në humbje ose fitim, menaxhmenti gjykon mbi bazën e faktorëve të tillë si cilësia e kredisë, madhësia e portofolit, përqendrimet, tendencat dhe sjellja e portofolit të kredisë dhe faktorët ekonomikë. Me qëllim vlerësimin e fondit të kërkuar, bëhen supozime të bazuara në eksperiencën historike, karakteristika të rrezikut të kreditimit në Organizatën dhe në institucione mikrofinanciare e të tjera kreditimi të tregut të Kosovës dhe kushtet aktuale ekonomike. Mjaftueshmëria e fondit për humbje të tilla, varet nga sa të sakta janë supozimet dhe parametrat e përdorur në përcaktimin e humbjes kolektive.

(ii) Tatimi mbi fitimin

Informata në lidhje me fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit që kanë efekt më të madh në shumat e tatimit mbi fitim të njohura në pasqyrat financiare, janë përfshirë në shënimin 19. Pozicionet e pasigurt në lidhje me taksat dhe tatimet rivlerësohen nga menaxhmenti në fund të çdo periudhe raportuese. Detyrimet për tatim fitimin regjistrohen në bazë të vlerësimit nga menaxhmenti që të mos rezultojë në taksa shtesë, nëse normat e tatimit mund të ndryshojnë nga organet tatimore. Vlerësimi është bazuar në interpretimin e ligjeve tatimore që janë në fuqi deri në fund të periudhës së raportimit dhe mbi vendimet gjyqësore apo vendime të tjera për çështje të tilla. Detyrimet për gjokat, interesat dhe taksa të tjera përveç tatimit mbi fitimin njihen në bazë të vlerësimit më të mirë nga menaxhmenti të shumës së kërkuar për të shlyer detyrimet.

KEP TRUST

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Euro, përveç nese shkruhet ndryshe)

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

(iii) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare për të cilat nuk ka çmime tregu të disponueshme, kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit të përmendura në politikat kontabël 3.3 (vi). Për instrumentet financiare që tregtohen rralë dhe kanë transparencë të ulët të çmimit, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon nivele të ndryshme gjykimi që varen nga likuiditeti, përqendrimi, pasiguria e faktorëve të tregut, supozimet mbi çmimin dhe rreziqe të tjera që ndikojnë instrumentin specifik. Politikat kontabël të Organizatës për matjen e vlerës së drejtë diskutohet në shënimin 3.3 (vi). Organizata mat vlerat e drejta duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të metodave:

- Niveli 1: Çmime të kuotuar në një treg aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknika vlerësimi bazuar në të dhëna të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuar duke përdorur: çmime të kuotuar në tregje aktive për instrumente të ngjashëm, çmime të kuotuar për instrumente të ngjashëm në tregje që konsiderohen me pak se aktive; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjithë të dhënat e rëndësishme janë të vëzhgueshme në mënyrë direkte ose jo-direkte nga të dhënat e tregut
- Niveli 3: Teknika vlerësimi që përdorin të dhëna të rëndësishme të pavëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë ato instrumente ku teknika e vlerësimit përfshin të dhëna që nuk janë të vëzhgueshme dhe të dhënat e pavëzhgueshme kanë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente që janë vlerësuar bazuar në çmime të kuotuar për instrumente të ngjashëm ku rregullimet apo gjykimet e rëndësishme të pavëzhgueshme kërkojnë për të reflektuar ndryshimin midis instrumenteve.

Organizata përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modele të skontimit të flukseve monetare, krahasime me instrumente të ngjashëm për të cilët ekzistojnë çmime të dukshme tregu dhe modele të tjera vlerësimi. Supozimet dhe inputet e përdorura në teknikat e vlerësimit përmbajnë norma interesi e marzhe krediti pa rrezik ose benchmarke, dhe luhatje apo korrelacione çmimesh të pritshme.

5. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Kur është e mundur, vlera e drejtë e kredive bazohet në transaksionet e tregut të vëzhgueshëm. Kur transaksionet e tregut të vëzhgueshëm nuk janë në dispozicion, vlera e drejtë vlerësohet duke përdorur modele vlerësimi, siç janë teknikat e skontimit të parasë. Të dhënat në teknikat e vlerësimit përfshijnë humbjet e pritshme të kredive gjatë jetës së tyre, dhe normat e interesit. Kreditë e vogla homogjene janë grupuar në portofole me karakteristika të ngjashme.

Vlera e drejtë e huave llogaritet duke përdorur teknika të skontimit të flukseve të mjeteve monetare, duke zbatuar normat që ofrohen për huamarrjet e maturimeve dhe afateve të ngjashme.

	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Vlera e drejtë Niveli 3	Vlera e mbartur	Vlera e drejtë Niveli 3	Vlera e mbartur
Aktivet financiare				
Huatë dhe paradhëniet për klientët	36,819,455	36,055,365	26,445,483	25,639,675
Detyrimet financiare				
Huamarrjet	23,753,453	23,642,135	14,095,873	13,971,140

Vlerat e mbartura të kredive dhe huamarrjeve më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, janë më të ulëta se vlerat e drejta, për shkak se normat aktuale të tregut prej 22.6% për kreditë dhe 5.7% për huamarrjet (2016: 21.3% për kreditë dhe 6.5% për huamarrjet) janë pak më të larta se normat kontraktuale.

KEP TRUST

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Euro, përveç nese shkruhet ndryshe)

6. Menaxhimi i riskut financiar

6.1 Hyrje dhe vështrim i përgjithshëm

Organizata është e ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve të saj financiare:

- risku kreditor
- risku i likuiditetit
- risku i tregut

Ky shënim shpalos informacionin mbi ekspozimin e Organizatës ndaj secilit prej risqeve më lart, objektivat e Organizatës, politikat dhe procedurat për matjen dhe menaxhimin e riskut dhe menaxhimin e kapitalit të Organizatës. Shpalosjet e mëtejme sasiore janë të përfshira në këto pasqyra financiare.

Korniza e menaxhimit të riskut

Bordi i Drejtorëve ka përgjegjësinë përfundimtare për të vendosur dhe mbikëqyrur kornizën e menaxhimit të riskut të Organizatës. Bordi dhe menaxhmenti kanë ngritur komitete të ndryshme të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të riskut në tërësi. Të gjitha komitetet kanë drejtorë ekzekutivë dhe jo-ekzekutivë, të cilët raportojnë rregullisht tek Bordi i Drejtorëve. Departamenti i Auditimit të Brendshëm bën rishikime të rregullta dhe rishikime të paprogramuara (ad-hoc) mbi kontrollat dhe procedurat e menaxhimit të riskut, rezultatet e të cilave i raportohen Bordit të Drejtorëve.

6.2 Risku kreditor

Risku kreditor është risku i humbjeve të Organizatës nëse një klient apo një palë në një instrument financiar dështon që të përmbush detyrimet e tija financiare dhe kryesisht lind nga kreditë dhe avancat e Organizatës ndaj klientëve apo bankave të tjera. Për çështje të raportimit lidhur me menaxhimin e riskut, Organizata i konsideron të gjitha elementet e ekspozimit ndaj riskut kreditor (siç janë risku i mospagesës nga klienti, risku në nivel vendi dhe sektori).

Ekspozimi kryesor i Organizatës ndaj riskut kreditor lind nga dhënia e huave dhe paradhënieve. Vlera e ekspozimit kreditor në këtë rast, përfaqësohet nga vlera e mbetur e aktiveve. Organizata nuk ka ekspozim të konsiderueshëm ndaj asnjë klienti apo pale individuale. Ekspozimi maksimal ndaj riskut kreditor shprehet nga vlera e mbetur e aktivitetit financiar. Bordi i Drejtorëve ka deleguar përgjegjësinë për menaxhimin e riskut kreditor tek menaxhmenti. Departamenti i Auditimit të Brendshëm bën auditime të rregullta të njësive të biznesit dhe proceseve të kreditimit.

Fondi për zhvlerësim

Organizata përcakton fonde për humbjet nga zhvlerësimi i huave, të cilat përfaqësojnë vlerësime për humbjet aktuale në portofolin kreditor. Këto fonde janë grupe, të përcaktuara për grupe të aktiveve të ngjashme, përkundrajt humbjeve që kanë ndodhur tashmë, por të cilat nuk janë identifikuar mbi huatë të cilat kanë qenë subjekt i vlerësimit individual për zhvlerësim.

Huatë me kushte të rinegociuara

Huatë me kushte të rinegociuara janë hua që janë ristrukturuar si pasojë e përkeqësimit të gjendjes financiare të huamarresit dhe ku Organizata ka bërë lehtësime, të cilat ndryshe nuk do t'i ofronte.

Pasi një hua ristrukturohet, duhet të klasifikohet minimalisht në kategorinë nënstandard ose më keq, dhe do të vazhdojë të klasifikohet në të njëjtën kategori derisa të vëzhgohet performanca e qëndrueshme (në lidhje me shlyerjen e principalit dhe interesit sipas skemës së ripagimit). Më 31 dhjetor 2017, huatë me kushte të rinegociuara të Organizatës janë 180,561 Euro (2016: 219,240 Euro). Fondi për zhvlerësim për huatë me kushte të rinegociuara më 31 dhjetor 2017 është 61,777 Euro (2016: 75,470 Euro).

KEP TRUST

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Euro, përveç nese shkruhet ndryshe)

6 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

6.2. Risku kreditor (vazhdim)

Politika e fshirjeve të huave

Organizata fshin një hua (dhe çdo fond përkatës për humbjet nga zhvlerësimi) kur menaxhmenti përcakton se kredia është e pa arkëtueshme. Ky përcaktim arrihet pas shqyrtimit të informatave të tilla si ndodhja e ndryshimeve të rëndësishme në pozicionin financiar të huamarrësit, në mënyrë që huamarrësi nuk mund të paguajë detyrimin, ose që të ardhurat nga kolaterali nuk do të jenë të mjaftueshme për të paguar tërë ekspozimin. Për huatë e vogla dhe të standardizuara, vendimet e fshirjes zakonisht bazohen në një status specifik të vonesës. Huatë përgjithësisht fshihen kur ato janë vonuar më shumë se 365 ditë (2016: 365 ditë), dhe asnjë pagesë nuk është bërë gjatë gjashtë muajve të fundit. Shuma totale e kredive të fshira është paraqitur në Shënimin 8. Rimarrjet nga kreditë e fshira janë paraqitur në Shënimin 16.

Klasifikimi dhe normat e interesit mesatar të huave sipas tipeve të produkteve janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	Norma e interesit	31 dhjetor 2016	Norma e interesit
Bujqësore	5,253,659	21.4%	3,928,736	21.7%
Konsumuese	3,980	17.9%	5,169	24.2%
Ekspres (pa kolateral)	10,596,602	24.5%	8,122,229	24.6%
Përmirësimi kushteve të banimit	12,798,339	22.7%	8,855,204	22.4%
Biznes individual	7,402,785	20.2%	4,728,337	20.1%
	36,055,365		25,639,675	

Kategoria	Huatë dhe paradhënie për klientët	
	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
A – Standarde	35,954,227	25,580,895
B – Vrojtuese	96,698	60,989
C – Nënstandarde	123,605	69,195
D – Të Dyshimta	140,840	103,896
E – Të Humbura	479,025	442,176
Huatë bruto	36,794,395	26,257,151
Minus: Fondi për zhvlerësim kolektiv	(588,541)	(544,775)
Minus: Fondi për zhvlerësim individual	(150,489)	(72,701)
Huatë neto për klientët	36,055,365	25,639,675

Normat e zhvlerësimit për humbjet e huave që rrjedhin nga modeli i zhvlerësimit dhe aplikohen nga Organizata janë si në vijim:

Kategoria	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
A – Standarde	0.22% - 20.36%	0.30% - 18.29%
B – Vrojtuese	6.7% - 20.36%	7.13% - 18.29%
C – Nënstandarde	5.0% - 32.61%	10.52% - 34.00%
D – Të Dyshimta	17.15% - 48.89%	20.12% - 50.68%
E – Të Humbura	23.44% - 78.77%	30.09% - 80.80%

Modeli i zhvlerësimit klasifikon kreditë në bujqësore, biznesi, konsumuese dhe përmirësim të kushteve të banimit, dhe secili grup ndahet më tej në kredi më lart ose nën 3,000 Euro. Për secilën nen-kategori llogaritet shkalla përkatëse e humbjes.

KEP TRUST

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017 (Të gjitha vlerat janë të shprehura në Euro, përveç nese shkruhet ndryshe)

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)
6.2. Risku kreditor (vazhdim)

Informacioni për huatë sipas sektorit dhe tipeve të kolateralit me 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është si në vijim:

Në Euro	Bujqësore	Konsumuese	Ekspres (pa kolateral)	Përmirësim i kushteve të banimit	Biznes individual	Gjithsej
Hua me kolateral						
Vetura	1,567,399	744	222,902	3,167,048	1,773,767	6,731,860
Prona	49,352	-	-	40,747	98,682	188,781
Sende	743,040	1,588	94,200	958,753	1,430,136	3,227,717
Hua pa kolateral	2,893,868	1,648	10,279,500	8,631,791	4,100,200	25,907,007
Hua dhe paradhënie gjithsej	5,253,659	3,980	10,596,602	12,798,339	7,402,785	36,055,365
Në Euro						
Hua me kolateral						
Vetura	1,384,433	2,153	316,250	2,741,396	1,376,809	5,821,041
Prona	74,924	-	-	54,679	110,745	240,348
Sende	545,351	2,339	112,309	904,908	1,093,151	2,658,058
Hua pa kolateral	1,924,028	677	7,693,670	5,154,221	2,147,632	16,920,228
Hua dhe paradhënie gjithsej	3,928,736	5,169	8,122,229	8,855,204	4,728,337	25,639,675

Organizata mban kolaterale kundrejt huave dhe avancave për klientët në formën e hipotekave, veturave dhe mallrave.

Vetura
Prona
Sende

31 dhjetor 2017
14,050,070
1,506,385
3,211,026
18,767,481

31 dhjetor 2016
13,432,578
1,354,037
2,636,948

Organizata nuk ka riposeduar asete gjatë vitit 2017. Pasuritë e riposeduara më 31 dhjetor 2016, janë fshirë plotësisht. Organizata është në përputhje me paragrafin 2 të nenit 3 të Rregullores së BQK-së të datës 29 gusht 2013, e cila përcakton jetëgjatësinë maksimale të aktiveve të riposeduara në organizatat mikrofinanciare. Menaxhmenti mallë ekzekuton kolaterale dhe mbështetet kryesisht në burimin e të ardhurave, karakterin dhe seriozitetin e huamarrësve dhe në marrëdhëniet me ta.

KEP TRUST

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Euro, përveç nese shëruhet ndryshe)

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

6.2. Risku Kreditor (vazhdim)

Analiza sipas cilësisë së huave në 31 dhjetor 2017 është si më poshtë:
Në Euro

	Bujqësore	Konsumuese	Ekspres (pa kolateral)	Përmirësim i kushteve të banimit		Biznes individual	Gjithsej
<i>As në vonesë, as të zhvlerësuara</i>							
Hua për individë nën 3,000 Euro	996,149	-	10,489,287	10,289	4,720	11,500,445	
Hua për individë mbi 3,000 Euro	4,144,068	-	13,455	12,637,969	7,211,438	24,006,930	
Gjithsej hua as në vonesë as të zhvlerësuara	5,140,217	-	10,502,742	12,648,258	7,216,158	35,507,375	
<i>Në vonesë, por jo të zhvlerësuara</i>							
- më pak se 30 ditë në vonesë	26,126	-	79,909	98,523	87,771	292,329	
- 30 deri 90 ditë në vonesë	17,196	1,982	32,733	24,509	20,278	96,698	
- 91 deri 180 ditë në vonesë	34,198	-	31,823	39,219	18,365	123,605	
- 181 deri 360 ditë në vonesë	22,359	-	44,889	48,947	24,645	140,840	
- mbi 360 ditë në vonesë	59,711	7,779	104,126	109,402	127,896	408,914	
Gjithsej në vonesë, por jo të zhvlerësuara	159,590	9,761	293,480	320,600	278,955	1,062,386	
<i>Huatë të përcaktuara për zhvlerësim individual (bruto)</i>							
- më pak se 30 ditë në vonesë	32,006	-	-	-	122,517	154,523	
- 181 deri 360 ditë në vonesë	10,803	-	-	-	-	10,803	
- mbi 360 ditë në vonesë	15,421	-	-	-	43,887	59,308	
Gjithsej të zhvlerësuara individualisht (bruto)	58,230	-	-	-	166,404	224,634	
Minus rezervat për zhvlerësim	104,378	5,781	199,620	170,519	258,732	739,030	
Gjithsej huatë dhe avancat për klientët	5,253,659	3,980	10,596,602	12,798,339	7,402,785	36,055,365	

KEP TRUST

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në Euro, përveç nëse shëruhet ndryshe)

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

6.2. Risku kreditor (vazhdim)

Analiza sipas cilësisë së huave në 31 dhjetor 2016 është si më poshtë:

Në Euro	Bujqësore	Konsumuese	Ekspres (pa kolateral)	Përmirësim i kushteve të banimit	Biznes individual	Gjithsej
<i>As në vonesë, as të zhvlerësuar</i>						
Hua për individë nën 3,000 Euro	981,288	243	8,053,725	15,942	19,884	9,071,082
Hua për individë mbi 3,000 Euro	2,881,885	-	18,181	8,805,159	4,558,576	16,263,801
Gjithsej hua as në vonesë as të zhvlerësuar	3,863,173	243	8,071,906	8,821,101	4,578,460	25,334,883
<i>Në vonesë, por jo të zhvlerësuar</i>						
- më pak se 30 ditë në vonesë	16,973	-	67,722	30,292	39,925	154,912
- 30 deri 90 ditë në vonesë	21,985	-	28,189	55,263	24,768	130,205
- 91 deri 180 ditë në vonesë	10,125	-	36,351	38,098	19,322	103,896
- 181 deri 360 ditë në vonesë	28,016	840	50,023	25,195	44,198	148,272
- mbi 360 ditë në vonesë	42,994	15,874	33,886	31,600	106,192	230,546
Gjithsej në vonesë, por jo të zhvlerësuar	120,093	16,714	216,171	180,448	234,405	767,831
<i>Huatë të përcaktuara për zhvlerësim individual (bruto)</i>						
- më pak se 30 ditë në vonesë	10,360	-	-	-	80,704	91,064
- 181 deri 360 ditë në vonesë	17,512	-	-	-	-	17,512
- mbi 360 ditë në vonesë	-	-	-	-	45,861	45,861
Gjithsej të zhvlerësuar individualisht (bruto)	27,872	-	-	-	126,565	154,437
Minus rezervat për zhvlerësim	82,402	11,788	165,848	146,345	211,093	617,476
Gjithsej huatë dhe avancat për klientët	3,928,736	5,169	8,122,229	8,855,204	4,728,337	25,639,675

KEP TRUST

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë në Euro, përveç nëse janë të shprehura ndryshe)

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

6.3. Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Organizata do ballafaqohet me vështirësi në përmbushjen e detyrimeve financiare.

Qasja e Organizatës në menaxhimin e riskut të likuiditetit është të sigurohet sa më mirë që të jetë e mundur, që do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet atëherë kur duhet, në situata normale dhe nën presion, pa pësuar humbje të paarsyeshme ose dëmtuar reputacionin e Organizatës.

Gjendja e likuiditetit të Organizatës monitorohet nga Departamenti i Financës në baza javore dhe mujore dhe direkt nga menaxhmenti në mënyrë sistematike, nëpërmjet menaxhimit të fondeve të disponueshme për disbursime dhe duke u siguruar se, në bazë të hyrje-daljeve të pritshme të parave në secilën llogari, fondet e mjaftueshme do jenë në dispozicion për të paguar detyrimet e Organizatës. Politikat e brendshme për menaxhimin e riskut të likuiditetit janë në pajtueshmëri me rregulloren "Mbi menaxhimin e rrezikut të likuiditetit në institucionet mikrofinanciare", të aprovuara nga Banka Qendrore e Kosovës në 29 gusht 2013.

Ekspozimi ndaj riskut të likuiditetit

Huamarrjet janë burimi kryesor i financimit për Organizatën. Organizata përpiqet të mbajë një balancë mes vazhdimësisë së fondeve dhe fleksibilitetit përmes përdorimit të huamarrjeve me maturitete të ndryshme. Organizata e vlerëson në vazhdimësi riskun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshimet në fondet e kërkuara për të arritur qëllimet dhe objektivat e biznesit, të caktuara në kuadër të strategjisë së përgjithshme të Organizatës.

Gjithashtu, Organizata mban një portofol me aktive likuide si pjesë e strategjisë së saj për menaxhimin e riskut të likuiditetit. Tabela e mëposhtme tregon detyrimet financiare të Organizatës, në bazë të maturitetit kontraktual me të hershëm të mundshëm:

	Deri në 6 muaj	6 muaj deri në 1 vit	Mbi 1 vit	Vlera e mbartur
31 dhjetor 2017				
Huamarrjet	5,520,733	6,094,833	12,026,569	23,642,135
Detyrime të tjera	212,754	-	-	212,754
	5,733,487	6,094,833	12,026,569	23,854,889
31 dhjetor 2016				
Huamarrjet	3,206,332	3,250,741	7,514,067	13,971,140
Detyrime të tjera	160,170	-	-	160,170
	3,366,502	3,250,741	7,514,067	14,131,310

6.4 Risku i tregut

Risku i tregut është risku që ndryshimet në çmimet e tregut, si normat e interesit, normat e këmbimit valutor dhe marxhinat e huasë do të ndikojnë të ardhurat e Organizatës ose vlerën e instrumenteve financiare në posedim. Qëllimi i menaxhimit të rrezikut të tregut është menaxhimi dhe kontrolli i ekspozimit ndaj rrezikut brenda parametrave të pranueshme, ndërkohë që optimizohet kthimi.

Ekspozimi ndaj riskut të normës së interesit

Risku i normës së interesit është rreziku që vlera e instrumenteve financiare do të variojë për shkak të ndryshimit në normat e interesit. Organizata menaxhon rrezikun e normës së interesit duke monitoruar kushtet e tregut dhe duke marrë vendimet e duhura për ndryshim çmimi ose për rialokim. Analiza e sensitivitetit është përcaktuar në bazë të ekspozimit ndaj normës së interesit për aktivet dhe detyrimet financiare, duke supozuar se vlerat e tyre të mbartura në datën e raportimit do ishin të njëjtat edhe gjatë vitit.

KEP TRUST**Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha vlerat janë në Euro, përveç nëse janë të shprehura ndryshe)***6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)****6.4. Risku i tregut (vazhdim)****Ekspozimi ndaj riskut te normës se interesit (vazhdim)**

Pozicionet nga diferencat në normat e interesit për kategoritë e rëndësishme të aktiveve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit në 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë si më poshtë:

	Deri në 6 muaj	6 muaj deri në 1 vit	Mbi një vit	Vlera e mbartur
31 dhjetor 2017				
Huatë dhe paradhëniet për klientët	9,934,659	8,272,041	17,848,665	36,055,365
	9,934,659	8,272,041	17,848,665	36,055,365
Huamarrje	5,520,733	6,094,833	12,026,569	23,642,135
	5,520,733	6,094,833	12,026,569	23,642,135
Pozicioni neto	4,413,926	2,177,208	5,822,096	12,413,230
	Deri në 6 muaj	6 muaj deri në 1 vit	Mbi një vit	Vlera e mbartur
31 dhjetor 2016				
Huatë dhe paradhëniet për klientët	6,947,341	5,948,228	12,744,106	25,639,675
	6,947,341	5,948,228	12,744,106	25,639,675
Huamarrje	3,206,332	3,250,741	7,514,067	13,971,140
	3,206,332	3,250,741	7,514,067	13,971,140
Pozicioni neto	3,741,009	2,697,487	5,230,039	11,668,535

Menaxhimi i riskut të normës se interesit plotësohet duke monitoruar sensitivitetin e aktiveve dhe detyrimeve financiare të Organizatës ndaj skenareve standarde dhe jostandarde të lëvizjes në normat e interesit. Skenaret standarde përfshijnë një rënie ose rritje paralele prej 1% në të gjitha kurbat e normave të interesit. Më poshtë paraqitet një analizë e sensitivitetit të Organizatës për një rritje ose rënie në normat e interesit në treg (duke supozuar se nuk ka lëvizje asimetrike në kurbat e normave të interesit dhe se kemi një pozicion konstant):

	2017	2016
Fitim: 1% rritje	124,132	116,685
Humbje: 1% rënie	(124,132)	(116,685)

Ekspozimi ndaj normës së këmbimit valutor

Risku i normës së këmbimit është risku që vlera e instrumenteve financiare do të variojë për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit valutore. Organizata nuk është e ekspozuar ndaj këtij risku sepse asetet dhe detyrimet janë në Euro.

6.5. Menaxhimi i kapitalit

Organizata është në pajtueshmëri me kërkesën për kapital minimal prej 200 mijë Euro të Bankës Qendrore të Kosovës. Organizata është subjekt i mbikëqyrjes periodike nga Banka Qendrore e Kosovës. Politika e Organizatës është mbajtja e një baze të fortë të kapitalit në mënyrë që të ketë besimin nga investitorët, kreditorët dhe nga tregu, dhe që të mbështesë zhvillimin e ardhshëm të biznesit. Po ashtu vlerësohet edhe ndikimi i nivelit të kapitalit në fitime dhe Organizata njihet nevojën e ruajtjes së një ekuilibri mes kthimeve më të larta që mund të jenë të mundshme me një borxh më të lartë, dhe avantazheve dhe sigurisë që ofron pasja e një pozite të shëndoshë, sa i përket kapitalit. Gjatë vitit, nuk ka patur ndryshime sa i përket qasjes së Organizatës në manaxhimin e kapitalit.

7. Paraja dhe ekuivalentët e saj

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Para në bankë	1,845,423	1,476,490
Para në arkë	316,879	303,410
	2,162,302	1,779,900

KEP TRUST**Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha vlerat janë në Euro, përveç nëse janë të shprehura ndryshe)***8. Huatë dhe paradhëniet tek klientët**

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Hua dhe paradhënie për klientët	36,794,395	26,257,151
Minus: rezerva për zhvlerësim	(739,030)	(617,476)
	36,055,365	25,639,675

Lëvizjet në rezervën për zhvlerësim janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Balanca në 1 janar	617,476	762,114
Ngarkesa për zhvlerësim, neto	292,234	124,003
Shumat e shlyera	(170,680)	(268,641)
Balanca në 31 dhjetor	739,030	617,476

Organizata ka siguruar huamarrjen nga Banka për Biznes me një portofol kredish prej 1,676,423 Euro më 31 dhjetor 2017 (2016: 1,945,305 Euro), dhe në bazë të kushteve kontraktuale të rëna dakord, kredi të tilla duhet të përfaqësojnë një Porfolio-Me-Risk Zero, dhe një ekspozim minimal aktual prej 150% të shumës së huasë (shih Shënimin 12).

9. Aktivet e tjera

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shpenzime të parapaguara	188,281	27,820
Paradhënie për punonjësit	12,534	7,802
Të tjera	9,862	7,064
	210,677	42,686

Shpenzimet e parapaguara përfshijnë parapagimet prej 166,499 Euro për një softuer të ri që do të implementohet gjatë vitit 2018.

10. Zyra dhe pajisje

	Mjete motorike	Kompjuterë dhe pajisje elektronike	Mobilje dhe rregullime	Përmirësime të hapësirave me qira	Gjithsej
Kosto					
Balanca më 1 janar 2016	582,563	414,594	620,955	430,784	2,048,896
Shtesa	125,016	37,523	14,590	10,710	187,839
Pakësime	(62,784)	(25,437)	(16,252)	(79,395)	(183,868)
Balanca më 31 dhjetor 2016	644,795	426,680	619,293	362,099	2,052,867
Shtesa	127,980	44,077	220,283	24,113	416,453
Pakësime	(115,190)	(18,102)	(51,978)	(62,856)	(248,126)
Balanca më 31 dhjetor 2017	657,585	452,655	787,598	323,356	2,221,194
Zhvlerësimi i akumuluar					
Balanca më 1 janar 2016	(568,920)	(376,582)	(592,564)	(375,768)	(1,913,834)
Zhvlerësimi për vitin	(12,781)	(20,899)	(20,892)	(21,460)	(76,032)
Pakësime	62,554	25,120	15,933	79,385	182,992
Balanca më 31 dhjetor 2016	(519,147)	(372,361)	(597,523)	(317,843)	(1,806,874)
Zhvlerësim për vitin	(30,464)	(22,420)	(39,242)	(15,410)	(107,536)
Pakësime	115,190	17,195	50,174	57,397	239,956
Balanca më 31 dhjetor 2017	(434,421)	(377,586)	(586,591)	(275,856)	(1,674,454)
Vlerat e mbetura					
Më 1 janar 2016	13,643	38,012	28,391	55,016	135,062
Më 31 dhjetor 2016	125,648	54,319	21,770	44,256	245,993
Më 31 dhjetor 2017	223,164	75,069	201,007	47,500	546,740

Me 31 dhjetor 2017, Organizata nuk ka asnjë pronë ose pajisje të lënë si kolateral (2016: zero).

KEP TRUST**Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha vlerat janë në Euro, përveç nëse janë të shprehura ndryshe)***11. Aktivet e paprekshme**

	Softuere
<i>Kosto</i>	
Balanca më 1 janar 2016	133,776
Shtesa	13,570
Balanca më 31 dhjetor 2016	147,346
Shtesa	24,260
Balanca më 31 dhjetor 2017	171,606
<i>Amortizimi i akumuluar</i>	
Balanca më 1 janar 2016	(126,831)
Shpenzimi për vitin	(6,945)
Balanca më 31 dhjetor 2016	(133,776)
Shpenzimi për vitin	(2,504)
Balanca më 31 dhjetor 2017	(136,280)
<i>Vlera e mbetur</i>	
Më 1 janar 2016	6,945
Më 31 dhjetor 2016	13,570
Më 31 dhjetor 2017	35,326

12. Huamarrje

Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, huatë e Organizatës janë si në vijim:

	Norma e interesit	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Responsibility	5.50% - 7%	6,750,000	3,875,000
Triple Jump	5% - 5.50%	4,000,000	-
Symbiotics	5% - 6.50%	3,500,000	1,000,000
EFSE	5.70% - 6.70%	3,200,000	1,000,000
Frankfurt School FSFS	5% - 6.50%	2,266,667	2,000,000
Blueorchard	5.60%	1,670,000	1,000,000
Microvest	6% - 7.50%	1,200,000	2,800,000
Banka per Biznes BpB	6% - 7%	785,160	623,851
CARITAS Switzerland	1%	85,000	85,000
ResponsAbility SIVAC (Lux)	6.90%	-	1,500,000
		23,456,827	13,883,851
Interes i përlogaritur		266,688	137,178
Tarifa e shtyrë		(81,380)	(49,889)
Gjithsej		23,642,135	13,971,140

Gjithsej shpenzimi i interesit për këto huazime në vitin 2017 është 1,271,871 Euro (2016: 717,925 Euro).

	2017	2016
Principali i mbetur më 1 janar	13,883,851	5,989,872
Disbursimet gjatë vitit	16,375,000	12,335,000
Pagesa gjatë vitit	(6,802,024)	(4,441,021)
Principali i mbetur më 31 dhjetor	23,456,827	13,883,851
Interesi dhe tarifat e përlogaritura më 1 janar	87,289	40,546
Shpenzimet e interesit	1,271,871	717,925
Interesi i paguar	(1,173,852)	(671,182)
Interesi dhe tarifat e përlogaritura më 31 dhjetor	185,308	87,289
Gjithsej	23,642,135	13,971,140

Organizata ka marrë një mbitërheqje nga BPB prej 250,000 Euro (2016: 250,000 Euro), me një normë interesi prej 8% në shumën e shfrytëzuar dhe maturimin më 15 prill 2018. Më 31 dhjetor 2017, Organizata nuk e ka shfrytëzuar këtë mbitërheqje.

KEP TRUST**Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha vlerat janë në Euro, përveç nëse janë të shprehura ndryshe)***13. Provizione**

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Për çështje gjyqësore	179,853	156,063
Provizione të tjera	7,314	6,048
	<u>187,167</u>	<u>162,111</u>

Provizionet për çështje ligjore janë kryesisht të lidhura me rastet gjyqësore të paraqitura nga ish punonjësit kundër Organizatës.

Provizionet e tjera përfshijnë një shume prej 7,314 Euro (2016: 6,048 Euro) lidhur me çështje të fituara në të kaluarën të cilat janë apeluar nga palë të treta dhe për të cilat menaxhmenti beson se do t'i humbë.

Lëvizjet në shpenzimet e provizionit janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Më 1 janar	162,111	151,521
Shpenzimet e provizionit	23,790	4,542
Provizioni për aktivet e tjera	1,266	6,048
Më 31 dhjetor	<u>187,167</u>	<u>162,111</u>

14. Detyrimet e tjera

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Interes i përllogaritur	60,964	47,851
Tatimi i interesit i mbajtur ne burim	44,445	41,453
Kontribute pensionale dhe tatim mbi të hyrat personale	45,551	22,055
Detyrime të tjera	61,794	48,811
	<u>212,754</u>	<u>160,170</u>

15. Të ardhurat nga interesi

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhurat e interesit nga kreditë dhe paradhënie	7,013,311	4,934,089
Të ardhurat e interesit nga bankat	3,981	4,209
	<u>7,017,292</u>	<u>4,938,298</u>

Më 31 dhjetor 2017, Organizata ka interes të përllogaritur me vlerën 42,575 Euro (2016: 38,096 Euro) për huatë në vonesë.

16. Të ardhurat e tjera

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Rimarrje nga huatë e fshira	256,702	298,907
Të ardhurat nga shitja e mjeteve fikse	24,548	-
Të ardhurat e tjera operative	12,611	16,159
	<u>293,861</u>	<u>315,066</u>

17. Shpenzimet e personelit

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Paga dhe kompensime	2,450,889	2,268,259
Kontribute të detyrueshme sociale dhe shëndetësore	124,891	113,536
Të tjera	82,826	76,721
	<u>2,658,606</u>	<u>2,458,516</u>

Më 31 dhjetor 2017, Organizata kishte punësuar 226 punonjës (2016: 222).

KEP TRUST**Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha vlerat janë në Euro, përveç nëse janë të shprehura ndryshe)***18. Shpenzimet administrative**

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shërbime juridike, konsulenca dhe tarifa profesionale	194,537	189,945
Shërbimet komunale	141,831	159,970
Siguria	137,014	148,891
Shpenzime të publicitetit dhe marketingut	101,230	88,096
Kompensime dhe udhëtime të Bordit	84,926	51,517
Derivate dhe parkim	57,546	50,894
Riparime dhe mirëmbajtje	51,415	51,121
Komunikimi	50,736	55,972
Furnizime të zyrës	50,197	40,389
Zhvillimi i stafit	40,567	4,954
Sigurime	28,986	20,302
Udhëtime	9,150	5,763
Akomodim	2,418	4,105
Shpenzime reprezentacioni	1,520	2,160
Të tjera	64,798	76,197
	1,016,871	950,276

19. Shpenzimet e tatimit

Tatimi mbi fitimin më 31 dhjetor 2017 është zero (2016: zero).

Pas ripërtërimit të Statusit të Përfitimit Publik në vitin 2017, Organizata nuk është e detyruar për të paguar tatim mbi të ardhurat dhe është përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat. Referojuni Shënimit 4 (iii).

20. Transaksione me palë të lidhura

Organizata ka marrëdhënie të ndërlidhura me drejtorët dhe menaxherët ekzekutivë. Siç përshkruhet në Shënimin 1, Organizata është një organizatë joqeveritare, prandaj nuk ka asnjë kompani mëmë ose aksionar.

Transaksionet me palë të lidhura

Një përmbledhje e kompensimeve dhe shpenzimeve të tjera për drejtorët dhe menaxhmentin kryesor për periudhat që përfunduan më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, është si në vijim:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	
	Kompensime	Shpenzime të tjera	Kompensime	Shpenzime të tjera
Kryeshefi ekzekutiv	78,196	693	67,450	3,895
Bordi i Drejtorëve	108,655	2,455	101,406	3,436
Drejtorët e tjerë	52,674	32,252	25,616	25,902
	239,525	35,400	194,472	33,233

KEP TRUST

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017

(Të gjitha vlerat janë në Euro, përveç nëse janë të shprehura ndryshe)

21. Kushtëzime dhe angazhime

Ligjore

Përveç provizioneve të krijuara deri më 31 dhjetor 2017 (shënimi 13), menaxhmenti mendon se nuk ka çështje të tjera gjyqësore apo pretendime nga palë të treta për të cilat Organizata do të duhet të paguajë apo humbasë një shumë të konsiderueshme parash në të ardhmen.

Angazhimet e qirasë

Organizata ka hyrë në angazhime të qirasë për zyrën qendrore dhe të gjitha degët e veta me maturitete nga 1 deri në 10 vite. Përgjithësisht, Organizata mund t'i përfundojë këto kontrata duke dhënë njoftime paraprake nga 1 deri në 6 muaj përpara. Si rezultat, maksimumi i angazhimit të paanulueshëm për pagesa deri në një vit është si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Brenda një viti	94,718	96,327
	94,718	96,327

22. Ngjarjet pas periudhës raportuese

Në vitin 2018, Organizata ka marrë më shumë financime nga institucionet financiare me një shumë totale prej 3,000,000 Euro dhe një normë interesi vjetore prej 5.7% , përveç huamarrjeve të detajuara në shënimin 12.

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit, që mund të kërkonin rregullime apo sqarime shtesë në këto pasqyra financiare.